

L I G J
Nr.8513, datë 15.7.1999

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS
TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR
TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE DHE TË
UDHËTARËVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2427, datë 22.7.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË BULLGARISË PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË
UDHËTARËVE DHE MALLRAVE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë, me pohstë të quajtura palë kontraktuese,

Me dëshirën për të kontribuar në zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike dhe tregëtare ndërmjet vendeve të tyre, si dhe për zhvillimin e transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve ndërmjet dy vendeve dhe tranzit përmes territoreve të tyre të bazuar në parimet e ekonomisë së tregut, ranë dakort si më poshtë:

PJESA I
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1.Kjo marrëveshje gjen zbatim në transportin rrugor, nga transportuesit e themeluar në territorin e njërës prej palëve kontraktuese, që nënkupton, mjetet e rregjistruara në atë vend ku kryhet nisja, destinacioni dhe tranziti, prej atij vendi, duke përfshirë edhe tranzitin përmes atij

territori dhe territorit të Palës tjetër kontraktuese.

2.Kjo marrëveshje nuk ka asnjë efekt mbi të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga angazhimet e tjera ndërkombëtare që kanë palët.

Neni 2 **Përkufizime**

Në këtë marrëveshje:

1.Me termin “transportues” kuptojmë personin fizik apo juridik të themeluar në një nga vendet e Palëve Kontraktuese, që kryen transportimin e udhëtarëve dhe të mallrave, për të cilin ai paguhet apo dhe vepron për llogari të tij, në përputhje me kërkesat dhe rregullat e legjislacionit kombëtar që kanë lidhje me fushën e transportit dhe të tregut.

2. Me “mjet” kuptojmë mjetin motorrik:

- në një njësi apo kombinime motorrike – për qëllim transporti rrugor të pasagjerëve dhe mallrave, në dispozicion të operatorëve, që mund të jenë pronë e tij, të marra me qera apo një kontratë lisingu.

3.”Rregjistrimi” kupton vendosjen e një numuri identifikimi tek mjeti nga autoritetet kompetente. Në rast se kemi të bëjmë me një kombinim mjetesh, mjeti motorrik është faktor kryesor në dalje apo dhe në përjashtim.

4. ”Transporti” nënkupton drejtimin e mjetit, të ngarkuar apo jo, pavarësisht nga lloji i mjetit, trailer apo semitrailer, që mund të transportohet për pjesë udhëtimi me tren apo anije.

5. ”Kabotazhi” nënkupton transporte në territorin e Palës kontraktuese të vendit pritës, me ngarkesë apo jo në pikat e caktuara në këtë vend, nga transportues të themeluar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Pjesa e fillimit dhe e mbarimit të një transporti të kombinuar ndërkombëtar nuk mund të konsiderohet kabotazh.

6. Me temrin “Veprimtaria e transportit për llogari të vet” kuptojmë transportin e udhëtarëve dhe mallrave për qëllime vazhdimi të biznesit të tij, apo në shërbim të punëdhënësve të tij, apo dhe si një organizatë jofitimprurëse për kryerjen e transportit të anëtarëve për qëllime sociale; për pasojë transporti kryhet pa pagesë duke siguruar se:

-Veprimtaria e transportit është vetëm një veprimtari ndihmëse për ndërmarrjen apo organizatën.

- Mjetet që përdoren janë pjesë e asaj ndërmarrje apo sektori, ose janë marrë me qera me afate të kufizuara, ose janë bërë subjekt i një kontrate lisingu me afat të gjatë dhe drejtohen nga anëtarët e stafit të ndërmarrjes apo të sektorit.

7. ”Transporti i kombinuar” nënkupton transportin e mallrave nëpërmjet kamionit, trailerit, semitrailerit, platformë ose kontanier, me ose pa traktor, që përdorin rrugën në fillim apo në fund të udhëtimit, dhe që mund të jetë hekurudhor, ujor a detar në pjesën tjetër.

8. ”Territori i Palëve Kontraktuale” kupton respektivisht territorin e Republikës së Shqipërisë dhe territorin e Republikës së Bullgarisë.

9. ”Vendi i Themelimit” nënkupton territorin e Palës Kontraktuese ku mjetet që operojnë janë të themeluara këtu bashkë me rregjistrimin e tyre.

10. ”Vendi pritës” nënkupton territorin e Palës Kontraktuese ku mjeti operon pa qenë i regjistruar dhe pa patur këtu themelimin e tij.

11. ”Autobuset dhe Vagonët” janë mjete që janë projektuar dhe ndërtuar për transport udhëtarësh dhe që kanë më shumë se 9 vende duke përfshirë dhe atë të shoferit.

12. ”Mjeti me qera” janë mjete që janë projektuar dhe ndërtuar për mbajtjen e 9 personave dhe bagazhet e tyre, përfshirë edhe shoferin që përdoret për transportin me pagesë për llogari të një pale të tretë.

13. ”Shërbime të rregullta” do të thotë shërbime që sigurojnë transportin e udhëtarëve sipas një frekuence dhe internerari udhëtimi të përcaktuar, ku udhëtarët merren apo liehn nëpër pikat e vendqëndrimeve të parashikuara. Shërbimet e rregullta duhet të respektojnë tarifat e

përcaktuara si dhe oraret.

Pavarësisht nga ai që organizon këto shërbime, termi “shërbime të rregullta” përfshin edhe shërbime të kategorive të veçanta të transportit të udhëtarëve, me përjashtim të disa rasteve ku ky shërbim ka të tjera kritere. Ky lloj shërbimi quhet “shërbim i rregullt i veçantë”.

14. “Shërbimi vajtje-ardhje” do të thotë shërbime, ku nëpërmjet mjet udhëtimit të parë të udhëtimeve të përsëritura në vajtje ose në kthim, grupe udhëtarësh të formuara që më parë transportohen nga një vend nisjeje në një destinacion, përkatësisht të gjendura në territore të dy Palëve Kontraktuese. Çdo grup që përbëhet nga udhëtarët që kanë udhëtuar në vajtje duhet të transportohen më pas në vendin e nisjes, në një udhëtim të mëvonshëm.

Zona e nisjes dhe e mbëritjes respektivisht nënkupton zonën ku udhëtimi nis dhe zonën ku udhëtimi mbaron të një lokaliteti rrethues me rreze 50 km.

Kthimi i udhëtimit të parë si dhe udhëtimi i fundit në vajtje në serinë e shërbimeve vajtje-ardhje do të jetë i zbratur.

Përkufizimi i “Shërbimi vajtje-ardhje” nuk përfshin faktin se disa pasagjerë bashkohen me grupin në kthim të udhëtimit, as edhe nga fakti se udhëtimit i parë në destinacion dhe udhëtimi i fundit për në pikën e fillimit janë kryer të zbratur. Ky lloj shërbimi vajtje-ardhje është quajtur e kundërta e vajtje-ardhjes.

“Shërbimi vajtje-ardhje” që përfshin akomodimin e të paktën të 80% të pasagjerëve për në destinacion dhe nëse është e nevojshme, me ose pa vakte të ngrënë, është quajtur “Shërbimi vajtje-ardhje me akomodim”.

15. “Shërbimet të rastit” kuptojmë ato shërbime që rrjedhin jo nga ndonjë përkufizim i shërbimeve të rregullta për pasagjerë as edhe nga ndonjë përkufizim i Shërbimit vajtje-ardhje.

16. “Kontrolli i dokumentave” kuptojmë biletat e autobuzëve e të vagonave, forma e të cilave është paraqitur në Joint Committee në referencën e Paragrafit 15.

PJESA II TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Neni 3 **Shërbimi i rregullt i udhëtarëve**

1. Shërbimi i rregullt i udhëtarëve vepron me autobuzë apo vagonë që janë subjekte të një sistemi të autorizuar nga autoritetet kompetente të vendit të nisjes, destinacionit e tranzitit.

2. Aplikimi për autorizim duhet të bëhet pranë autoriteteve kompetente në vendin e themelimit të transportuesit. Nëse autoritetet aprovojnë aplikimin, këtë ia komunikojnë autoriteteve kompetente të Palët tjetër Kontraktuese. Nëse nuk ka reciprocitet, autorizimet për shërbimet e rregullta bilaterale mund të refuzohen.

Komiteti i përbashkët që ngrihet në bazë të nenit 15 vendos mbi formën e aplikimit për autorizim dhe për procedurat e marrëveshjes dhe dokumentat mbështetëse që kërkohen.

3. Autorizimet lëshohen sipas marrëveshjes së përbashkët nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese.

Vendimi për të aprovuar apo refuzuar një autorizim merret brenda një periudhe prej 3 muajsh nëse nuk ka rrethana të veçanta.

4. Ndryshimet për kushtet e veprimtarisë dhe për heqjen e shërbimeve vendosen në përputhje me procedurat e pikave 2 dhe 3.

Nëse gjatë kësaj periudhe nuk ka ndonjë kërkesë për shërbim, transportuesi mund ta pezullojë shërbimin, duke njoftuar autoritetet kompetente të cilët kanë lëshuar autorizimin si dhe klientët, 3 javë përpara pezullimit të shërbimit.

5. Nëse një shërbim operon mbi bazat e një nënkontrate, autorizimi lëshohet në emër të firmës kryesore, dhe në të cilin emrat e nënkontraktuesve janë në gjendje të provojnë se transporti është çuar deri në fund në emër të firmës kryesore.

Neni 4
Shërbimi vajtje-ardhje

1. Shërbimi i rregullt i udhëtarëve vepron me autobuzë apo vagonë që janë subjekte të një sistemi të autorizuar nga autoritetet kompetente të vendit të nisjes, destinacionit e tranzitit.

2. Aplikimi për autorizim duhet të bëhet pranë autoriteteve kompetente në vendin e themelimit të transportuesit. Nëse autoritetet aprovojnë aplikimin, këtë ia komunikon autoriteteve kompetente të Palës tjetër Kontraktuese. Nëse nuk ka reciproritet, autorizimet për shërbimet e rregullta bilaterale mund të refuzohen.

Komiteti i përbashkët që ngrihet në bazë të nenit 15 vendos mbi formën e aplikimit për autorizim dhe për procedurat e marrëveshjes dhe dokumentet mbështetëse të kërkuara..

3. Komiteti i përbashkët mund të përcaktojë një sistem më liberal për shërbimet vajtje-ardhje.

Neni 5
Shërbimet e rastësishme

1. Shërbimet e rastësishme të kryera me autobus ose me vagon janë subjekt i një sistemi autorizimesh të lëshuara nga Autoriteti Kompetent në vendin e nisjes, mbërritjes apo tranzitit.

2. Si përjashtim i pikës 1, shërbimet e renditura më poshtë përjashtohen nga çdo lloj sistemi autorizimesh në territorin e vendit pritës;

2.1. udhëtimet me dyer të mbyllura ku i njëjti mjet përdoret për të transportuar të njëjtin grup pasagjerësh gjatë gjithë udhëtimet dhe për t'i kthyer ata në vendin e nisjes;

2.2. shërbimet që bëjnë udhëtimin në vajtje me udhëtarë dhe udhëtimin e kthimit bosh;

2.3. shërbimet që bëjnë udhëtimin në vajtje bosh dhe udhëtimin e kthimit me pasagjerë, me kusht që udhëtarët:

a) të përbëjnë një grup të formuar në bazë të një kontrate udhëtimi që është përfunduar përpara mbërritjes së tyre në territorin e Palës Kontraktuese, ku ata merren dhe dërgohen në territorin e vendit ku ka qendrën transportuesi.

b) të jenë sjellë më parë nga i njëjti transportues në territorin e Palës Kontraktuese, ku ata janë marrë përsipër dhe janë dërguar në territorin e vendit, ku ka qendrën transportuesi.

c) të jenë ftuar të udhëtojnë në territorin e vendit, ku ka qendrën transportuesi, dhe shpenzimet e transportit mbulohen nga personi që ka bërë ftesën.

2.4. Shërbimet për llogari të vet.

3. Marrja e pasagjerëve në një udhëtim me shërbim të liberalizuar nuk lejohet nëse nuk është dhënë një autorizim i veçantë.

Komisioni i Përbashkët, krijuar në bazë të nenit 15 të kësaj marrëveshje, mund të përjashtojë nga pajisja me autorizim kategori të tjera të shërbimeve të rastësishme.

4. Komisioni i Përbashkët, i krijuar në bazë të nenit 15 të kësaj marrëveshje, vendos për mënyrën e lëshimit të autorizimeve.

5. Shërbimeve të rastësishme të përjashtuara nga kërkesa për autorizim dhe të kryera me autobusa ose vagona, mund të shoqërohen me një dokument kontrolli. Kushtet e përdorimit dhe përmbytjes së dokumentit të kontrollit përpilohen nga Komisioni i Përbashkët, të cilit i referohet neni 15 i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6
Dispozita të përbashkëta për shërbimet e pasagjerëve

1. Autorizimet e transportit janë personale dhe nuk janë të transferueshme tek transportuesit e tjerë.

2. Kryerja e shërbimit kabotazh nuk lejohet. Udhëtimet lokale të organizuara vetëm me një grup pasagjerësh të sjellë në atë vend nga i njëjti transportues nuk gjykohet të jenë shërbime kabotazh, në qoftë se ato nuk janë përfshirë në biletën e udhëtimit.

PJESA III TRANSPORTI I MALLRAVE

Neni 7 Sistemi i lejes

1. Transporti i mallrave midis territoreve të dy Palëve Kontraktuese, i kryer me mjete të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Bullgarisë, përjashtohen nga kërkesat për leje.

2. Transportuesit, që kanë qendrën në territorin e Palës Kontraktuese, në bazë të sistemit të lejes për të cilin është rënë dakort mund të ndërmarrin pa kufizim:

- a) tranzitin nëpër territoret e Palëve Kontraktuese;
- b) transportin në/nga vende të treta.

3. Kabotazhi lejohet vetëm me autorizim të veçantë të vendit pritës.

Neni 8 Përjashtimi nga kërkesat për leje

1. Si përjashtim i nenit 7, paragrafi 2, katagoritë e mëposhtme të transportit përjashtohen nga kërkesat për leje:

1.1. Transporti me mjete Pesha e Përgjithshme e Ngarkesës së Lejuar (PPNL), duke përfshirë trailerat nuk i kalon të 5 tonet, ose kur pesha e përgjithshme e lejuar, duke përfshirë trailerat nuk i kalon të 3.5 tonët.

1.2. Transporti i herëpashershëm për në aeroporte ose nga aeroportet në rastet kur shërbimet ajrore ndryshojnë drejtim.

1.3. Transporti i mjeteve që janë dëmtuar ose janë prishur, dhe transporti i mjeteve të pridhura që janë për riparim.

1.4. Udhëtimet pa ngarkesë të një automjeti që dërgohen për të zëvendësuar një automjet që është prishur në një vend tjetër, dhe udhëtimi i kthimit, pas riparimit të automjetit që është prishur.

1.5. Transporti i gjësë së gjallë në automjete të prodhuara posaçërisht për këtë qëllim ose në automjete të destinuara përfundimisht për këtë lloj transporti dhe njihen si të tillë nga autoritetet kompetente në vendin ku ka qendrën transportuesi;

1.6. Transporti i pjesëve të këmbimit dhe i rezervave për anije transoceanike dhe avione.

1.7. Transporti i mallrave që nevojiten për raste urgjencash, në mënyrë më të veçantë për të plotësuar nevojat në rast fatkeqësish natyrore dhe nevojat humanitare.

1.8. Transporti i veprave dhe objekteve të artit për panaire dhe ekspozita apo për qëllime jotregëtare.

1.9. Transporti për qëllime jotregëtare të pasurive, aksesorëve dhe kafshëve për shfaqje teatrore, muzikore, filmike, sportive apo për shfaqje cirku, dhe të atyre që dërgohen për regjistrime në radio apo për xhirimenë njëfim apo televizion.

1.10. Udhëtimi i parë i automjeteve të blera rishtazi.

1.11. Transporti funeral.

1.12. Pjesa fillestare dhe përfundimtare-ndërkombëtare dhe kombëtare-të udhëtimit me tokë të ngarkesës intermodale, me kusht që, përkatësisht, të përdoret terminali i përshtatshëm hekurudhor më i afërmi me pikën e ngarkimit apo të shkarkimit të ngarkesës ose që porti lumor ose detar i ngarkimit apo shkarkimit që ndodhet brenda 150 km nga pika e ngarkimit apo e

shkarkimit të mallrave.

1.13. Transporti i mallrave shtëpiake të transportueshëm.

1.14. Transporti i postës.

2. Transporti i mallrave që kalben, është subjekt i një sistemi leje që nuk përcakton kuota.

3. Komisioni i Përbashkët, që i referohet nenit 15 të kësaj marrëveshjeje, mund të përjashtojë nga kërkesat për leje lloje të tjera transportimi të ngarkesave të veçanta apo të të gjitha ngarkesave përgjatë destinacioneve të përcaktuara.

4. Transportet e kryera nga ndërmarrjet me personel dhe pajisje të veçanta për këtë qëllim janë subjekt i një sistemi leje që nuk përcakton kuota, forma dhe gjëndja e përdorimit të të cilave vendoset nga Komisioni i Përbashkët që i referohet nenit 15.

Neni 9

Kushtet e lejes

1. Autoritetet kompetente të të dy Palëve Kontraktuese çdo vit shkëmbejnë një numër të përcaktuar formularësh leje bosh.

Lejet u jepen transportuesve banues nga autoriteti kompetent apo nga një organizëm i zgjedhur nga autoriteti në fjalë.

2. Lejet janë personale dhe nuk janë të transferueshme tek pala e tretë.

3. Lejet mund të përdoren vetëm për një mjet në çdo kohë. Lejet mund të jenë të vlefshme deri më 31 janar të vitit pasues kalendarik. Me rastin e kombinimeve të mjeteve, automjeti është faktori përcaktues në përdorimin e lejes apo përjashtimin nga leja.

4. Komisioni i Përbashkët, që i referohet nenit 15 të kësaj marrëveshjeje, përcakton numrin dhe llojin e lejeve në përputhje me nenin 7, paragrafi 2, që Palët Kontraktuese duhet të shkëmbejnë çdo vit, si dhe çdo lloj kushti tjetër që përcakton dhënien e lejes.

PJESA IV

DISPOZITA STANDARDE

Neni 10

Dispozitat për taksat

1. Karburanti që dispozita normale e mjeteve, që prodhohen nga prodhuesit, dhe që përdoret për ngarjen e mjetit dhe funksionimin e motorëve, si edhe lubrifikantët dhe pjesët e këmbimit janë të përjashtuara nga të gjitha taksat e importit në territorin e vendit pritës, me kushte që transportuesi t'u përmbahet rregullave përkatëse të doganës.

2. Në vendin pritës transporti për të cilën flitet në këtë Marrëveshje, është subjekt i tarifave dhe taksave të përcaktuara për përdorimin e rrjeteve rrugore apo urave.

Komisioni i Përbashkët që i referohet nenit 15, në bazë reciproke mund të përjashtojë nga disa lloje transportesh.

Neni 11

Peshat dhe përmasat

1. Peshat maksimale e lejueshme, peshë aksiale dhe përmasat e mjetit nuk duhet t'i kalojë ato, që janë përcaktuar në dokumentat e regjistrimit as kufijtë maksimale, që janë në fuqi të vendit pritës.

2. Transporti në vendin e pritjes me mjete peshat, përmasat ose peshat e të cilave i kalojnë kufijtë maksimalë të lejueshëm, lejohet vetëm me anë të një lejeje të veçantë të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit pritës.

Neni 12

Pajisjet dhe karakteristikat e tjera

1.Mjetet që transportojnë mallra të dëmshme, duhet të pajisen me mjetet e nevojshme në përputhje me kërkesat e Konventës ADR.

2.Pajisjet e përdorura për vëzhgimin e ekipit në ngarjen e mjetit dhe kohën e pushimit të mjeteve duhet të jenë në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës kombëtare të Palëve Kontraktuese.

3.Palët Kontraktuese marrin përsipër të nxisin, brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, përdorimin e mjeteve që plotësojnë standartet e sigurimit dhe të mjedisit.

Kur përcakton kuotat dhe liberalizimin e ardhshëm, Komisioni i Përbashkët, që i referohet në nenin 15, mund t'i trajtojë në mënyrë më të favorshme mjetet, që plotësojnë standartet më moderne të sigurimit të mjedisit.

Neni 13

Kontrolli

Lejet, dokumentat e kontrollit dhe shkresat e tjera, që kërkohen plus në bazë të kësaj marrëveshjeje, duhet të mbahen në mjete dhe mund të tregohen me kërkesën e zyrtarëve të kontrollit.

Komisioni i Përbashkët, që i referohet në Nenin 15, cilëson dokumentin e lëshuar nga vendi ku qëndron transportuesi, që jep të dhëna për statusin e transportuesit për llogari të vet.

Neni 14

Detyrimet e transportuesit dhe penaliteti

1.Transportuesit e një Pale Kontraktuese kanë për detyrë që, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet shumëpalëshe në të cilat të dyja palët janë Palë kontraktuese nga Marrëveshja aktuale, si dhe nga marrëveshje të tjera dypalëshe, dhe nga legjislacioni kombëtar, në mënyrë të veçantë nga rregullat e trafikut, rregullat e doganës dhe kushtet e kufizime të tjera.

2.Autoritetet kompetente, ku mund të ketë qëndrën transportuesi, në rast shkeljes serioze ose të përsëritura në territorin e vendit pritës, dhe me kërkesën e këtij të fundit, marrin vendimet administrative si më poshtë:

-Lëshojnë një paralajmërim

-Ndalojnë hyrjen në territorin e Palës Kontraktuese ku është bërë (janë bërë), sheklja (shkeljet).

Palët Kontraktuese duhet ta informojnë reciprokisht njëra-tjetrën për vendimet e marra.

Neni 15

Bashkëpunimi dhe Komisioni i Përbashkët

1.Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese duhet të marrin hapat e nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe t'i kalojnë njëra-tjetrës çdo informacion të dobishëm.

Autoritetet kompetente gjithashtu duhet të informojnë reciprokisht njëra-tjetrën për çdo lloj ndryshimi në ligjin kombëtar, që ndikon në zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Autoritetet kompetente duhet t'i japin njëra-tjetrës ndihmë reciproke me qëllim zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

2.Do të krijohet një Komision i Përbashkët i përbërë nga delegatë nga secila Palë kontraktuese për arsytet e parashtruara në pikën 1.

Komisioni i Përbashkët është përgjegjës për zbatimin e neneve 2,3,4,5,8,10,12 dhe 13 të

kësaj Marrëveshjeje dhe, në përgjithësi për rishikimin e të gjitha çështjeve që lidhen me marrëdhënet midis Palëve Kontraktuese në fushën e transportit rrugor.

Neni 16

Autoritetet kompetente

Sipas kësaj Marrëveshjeje, Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese duhet të jenë si më poshtë:

- Për Republikën e Shqipërisë: Ministria e Punëve Publike dhe e Transportit
- Për Republikën e Bullgarisë: Ministria e Transportit.

PJESA V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1.Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 ditë pas datës së marrjes së njoftimit të dytë me anë të të cilit Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike se kërkesat e legjislacionit përkatës kombëtar, të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, janë përmbushur.

2.Marrëveshja do të mbetet në fuqi për një periudhë prej 3 vjetësh pas hyrjes së saj në fuqi. Paskëtaj ajo do të vazhdojë të mbetet në fuqi në mënyrë të papërcaktuar, në qoftë se nuk jepet njoftim me shkrim nga çdonjëra Palë kontraktuese për skadimin e saj, skadim ky që hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese.

3.Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje shfuqizohet Marrëveshja e Qeverisë së Republikës së Bullgarisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, për Transportin Rrugor të Pasagjerëve e Mallrave, firmosur në 1 Gusht 1991në Sofie.

Nënshkruar në Tiranë me 12.3.1999 në tri kopje origjinale në gjuhët shqip, bullgarisht dhe anglisht, ku autenticiteti i çdo teksti është i barasvlershëm.

Në rast të ndonjë divergjence të interpretimit, teksti në anglisht do të jetë mbizotërues.

PËR QEVERRINË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERRINË REPUBLIKËS SË
BULLGARISË